

Koha Jonë

Rr: "Sami Frasheri"
Pallatet e Aviacionit Nr.2

SHENIMET SHPJEGUESE

-Informacion I Pergjithshëm per shoqërine.

Shoqëria "Koha Jonë" shpk është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Tiranë me Nr CN-262041-11-13. Date 11.03.1994 si Shoqëri Tregetare me pergjegjësi te kufizuar.

Kapitali i shoqërisë është 15.000.000 lekë dhe është derdhur plotësisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë z.Nikoll Lesi. i cili është administrator i shoqërisë.

Me 31 Dhjetor 2021 shoqëria kishte te punësuar 11 vetë.

Eshtë e regjistruar si person juridik në Drejtorin Rajonale Tatimore .Tiranë me Nipt K71425013C

Pasqyrat financiare te shoqërisë per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 janë hartuar nga Fabiola Doda . Ekonomiste Finance e punësuar në kompani.

Pasqyrat financiare janë miratuar nga Administratori e Shoqërisë me 10.03.2022

- PARIMET E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

(i) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqëria per hartimin e pasqyrave financiare per periudhen 01/01/2021 – 31/12/2021 është mbështetur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit si dhe ne ligjin 9228 date 29.04.2004"Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

(j) Parimet e pergatitjes

Pasqyrat financiare janë pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike
Politikat kontabel te meposhtme janë zbatuar ne vijimesi ne periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare.

© Monedhat funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare janë pergatitur ne leke ne perputhje me sistemin kontabel ne Shqiperi.

